

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË / Departamenti i përgjithshëm**, Gjyqtari Kujtim Krasniqi, me Zyrtaren Ligjore Dafina Ymeri, në çështjen penale kunder te pandehurit B.F.nga fsh D.1, për shkak të veprës penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e Urdhërit Ndëshkimor, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, të Prokurorisë Themelore në Prishtinë / Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.1392/16, të datës 06.02.2017, jashtë seancës, me datë 29.01.2018, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

**PRANOHET** kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP/II.nr. 1392/16, të datës 06.02.2017, për shqiptimin e urdhërit ndëshkimor,

Andaj gjykata konform nenit 495 të KPPK-së, jep:

### URDHËR NDËSHKIMOR

#### I akuzuari;

**B.F.**, nga i ati F. dhe e ëma Xh.,e gjinisë N., i lindur me ..., në fshatin D.1,D.2, ku edhe jeton, me numër personal ..., Shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës.

### ËSHTË FAJTOR

#### Sepse:

Me date 16.01.2016, rreth orës 06:30 , në TC Kosova A, në Obiliq, i pandehuri me dashje ka dëmtuar pasurinë e TC Kosova A, përkatësisht aparatën digjital për vendosjen e kartelave të punës dhe evidentimin e mëditjeve në atë mënyrë që e ka goditur me grusht duke e bërë atë të papërdorshëm, vlera e të cilit është rreth 480 euro, dhe duke shkaktuar dëm material për TC Kosova A,-

- **me këtë ka kryer veprën penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par.1 të KPRK-së.**

Andaj gjykata konform neneve 4, 41, 43, 46, 73 të KPK, si dhe neneve 365 e 495, të KPPK-së i shqipton:

### DËNIM ME GJOBË

Në shumën prej **200 (dyqind) Euro**, të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi

Dënimin e shqiptuar i pandehuri mund ta paguajë deri në 2 (dy) këste mujore në afat kohor prej 2 (dy) muaj, por jo më shumë se 2 (dy) muaj nga dita e marrjes së formës së prerë e këtij aktgjykimi.

Në rast se i pandehuri nuk e paguan dënimin e shqiptuar, gjykata mundësinë e pagesës me këste do ta revokoj dhe konform nenit 46 të KPK-së, i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgimi **duke llogaritur çdo 20 (njëzet) euro me 1 (një) ditë burg.**

**Obligohet:** i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor gjykatës t'ia kompensojnë shumën prej **30 euro**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit me detyrim.

**I dëmtuari:** Termocentrali “Kosova A” - përmes përfaqësuesve, lidhur me realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr. 1392/16, të datës 06.02.2017, kundër të akuzuarit B.F.nga fsh D.1, për shkak të veprës penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par.1 të KPRK-së.

Gjykatës i është propozuar që kundër të akuzuarit të lëshoj Urdhërin Ndëshkimor me arsyetimin e besueshëm nga kallëzimi penal dhe provat e bashkangjitura lidhur me bazueshmërinë e aktakuzës së prokurorisë në drejtim të vërtetimit të fakteve se i akuzuari vërtetë e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes e konform nenit 493 të KPPK-së Gjyqtari i vetëm gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495 të KPPK-së dhe mori vendim që ta pranoj kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës si: Kallëzimi penal, Deklarata e te dëmtuarit, si dhe provat tjera përcjellëse janë prova të mjaftushme me të cilat vërtetohet se i akuzuari ka kryer veprën penale e cila ju vihet në barrë.

Andaj Gjykata duke u bazuar në këto prova të besueshme vërtetoi se në veprimet e të akuzuares ekzistojnë elementet e veprës penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par.1 të KPRK-së, për këtë edhe i shqiptoi urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale, u mor konform nenit 450 par.1 dhe 2 nënpar 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

Në bazë të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPK-së, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të neneve 365 e 495 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**

Departamenti i përgjithshëm-Penal

P.nr.651/17, të dt. 29.01.2018

**Zyrtare Ligjore**

Dafina Ymeri

**Gjyqtari,**

Kujtim Krasniqi

**KËSHILLA JURIDIKE;**Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim në afat prej 8 ditësh nga marrja e të njëjtit, kësaj Gjykate, pas kalimit të afatit për kundërshtim urdhri ndëshkimor, merr formën e prerë.